



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

## Raport Konsultativ

Shqyrtimi i shtatë i tarifave të energjisë elektrike

**SHTE7 (2013-2017)**

**Vlerësimet e përkohshme – Dokumenti i përgjithshëm**

### DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është hartuar nga ZRRE për qëllime të pranimit të komenteve eventuale nga palët e interesit. Dokumenti nuk përfaqëson vendim të ZRRE-së.

**8 janar 2013**

## **Përmbajtja**

<b>1</b>	<b>Përmbledhje ekzekutive .....</b>	<b>2</b>
<b>2</b>	<b>Hyrje.....</b>	<b>4</b>
<b>3</b>	<b>Harmonizimi i vitit rregullativ me vitin kalendarik .....</b>	<b>4</b>
<b>4</b>	<b>Kohëzgjatja e kontrolleve .....</b>	<b>5</b>
<b>5</b>	<b>Ndryshimet në periudhën e ardhshme të kontrollit .....</b>	<b>5</b>
5.1	Investimet e ardhshme në Gjenerim .....	5
5.2	Tantiema për shfrytëzim të linjitit .....	6
5.3	Balanca e energjisë dhe importet .....	6
5.4	Privatizimi i Shpërndarjes dhe i Furnizimit të KEK-ut.....	7
5.5	Reflektimi i kostos .....	7
<b>6</b>	<b>Zhvillimi i MAR-ëve.....</b>	<b>7</b>
<b>7</b>	<b>MAR – Ndryshimet dhe komponentët .....</b>	<b>8</b>
7.1	Ndryshimet në SHTE6.....	8
7.2	Alokimi i kostove së administratës qendrore në Divizionet e licencuara .....	8
7.3	Përshtatjet e ZRRE-së në Capex e Opex .....	8
7.4	Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit (WACC) .....	9
7.5	Faktorët e efikasitetit.....	10
<b>8</b>	<b>Vlerësim i përkohshëm i MAR-it.....</b>	<b>11</b>
8.1	MAR-et e përkohshme .....	11

## 1 Përmbledhje ekzekutive

ZRRE ka përfunduar Vlerësimin e vet të përkohshëm për të hyrat maksimale të lejuara (MAR) për të licencuarit e energjisë elektrike. Në përcaktimin e MAR, ZRRE ka zbatuar dispozitat e legjislacionit primar dhe Rregullat e veta të përcaktimit të çmimeve. Ky dokument prezanton propozimet e përkohshme të ZRRE-së në kuadër të shqyrtimit të shtatë të tarifës së energjisë elektrike (SHTET7).

ZRRE propozon që MAR të përcaktohet për periudhë pesë vjeçare për divizionet e transmisionit dhe të shpërndarjes, katër vite për gjenerimin e rregulluar dhe për një vit për furnizuesin publik.

Pas konsultimit për këto MAR të përkohshme dhe një Dëgjimi publik i cili do të caktohet për fillim të shkurtit, ZRRE do të marrë vendimin përfundimtar. Të licencuarit pastaj do të propozojnë tarifa në përputhje me MAR-in përfundimtar, të cilët do të hyjnë në fuqi më 1 prill 2013. Në mënyrë që të harmonizohet viti rregullativ kontabël me vitin statutor kontabël, viti i parë i kontrollit të të hyrave fillon më 1 prillit dhe përfundon më 31 dhjetor.

Kompanitë kanë propozuar nivele të shpenzimeve kapitale dhe operative për pierudhën rregullative. ZRRE i ka shqyrtuar këto me kujdes me ndihmën e inxhinierëve konsultues. Për KOSTT-in, nivelet e propozuara të shpenzimeve kapitale (capex) janë arsyetuar në mënyrë adekuate, dhe ZRRE propozon që këto t'i lejojë në tërësi. KEK-u nuk i ka arsyetuar në tërësi shpenzimet e veta të parapara, dhe në vendimin përfundimtar të ZRRE-së mund të aplikohen zbritje të mëtejme nëse nuk ofrohet arsyetim i duhur për investimet e propozuara në mihje. ZRRE ka propozuar një numër të ndryshimeve në capex-in e kompanisë:

Ndryshimet e capex-it të aplikuara nga ZRRE sipas subjektit të licencuar	Parashikim i kompanisë €m	Vlerësimi i ZRRE-së €m	Ulja %
KEK Mihja	160	145	-9%
KEK Prodhimi A	65	56	-14%
KEK Prodhimi B	40	40	0%
KOSTT	120	120	0%
OSSH	114	100	-12%
FPEE	2	2	0%

Ngjashëm, kostot operative propozohet të ulen për të gjithë të licencuarit:

Ndryshimet e ZRRE-së në sipas të licencuarve	Parashik. i kompanisë €m	Vlerësimi i ZRRE-së €m	Ulja %
KEK Minierat	191.5	167.7	-13%
KEK Gjenerimi A	84.5	75.6	-11%
KEK Gjenerimi B	71.2	65.0	-9%
KOSTT	61.5	38.7	-37%
OSSH	86.9	76.6	-12%
FPEE	71.4	61.6	-14%

## Vlerësimi i përkohshëm - Pasqyrë

Për të nxitur kompanitë që të identifikojnë kursime të kostove gjatë periudhës, ZRRE propozon faktor të efikasitetit të cilët do të aplikohen për kostot operative të të licencuarve çdo vit. Propozimi i ZRRE-së është që divizioneve të Minierës dhe të Gjenerimit si dhe KOSTT-it t'ju aplikohet faktor i efikasitetit prej 4% vjetore. Për divizionin e shpërndarjes, faktorët janë të para-caktuar nga ZRRE në shkurt të vitit 2012 në 0% për tre vitet e para të kontrollit. ZRRE propozon që për 2 vitet e fundit të Periudhës Rregullative të aplikojë faktorë efikasiteti prej 5%.

WACC (Mesatarja e ponderuar e koston së kapitalit) përfaqëson koston e pritur të financimit të investimeve nga të licencuarit. WACC për Shpërndarjen dhe Furnizimin e KEK-ut është caktuar në 12% (në terma reale) me vendimin e Bordit të ZRRE-së në shkurt të vitit 2012. WACC për të licencuarit e tjerë llogaritet si mesatare e ponderuar e kthimit të vlerësuar në ekuitet dhe koston së realizuar të borxhit afatgjatë për çdo të licencuar, i cili variron prej 5.50% për mihje deri në 6.89% për Gjenerim.

Marrë së bashku, vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së për MAR iu lejon të licencuarëve që të vazhdojnë të investojnë në sistemin e energjisë elektrike. Grafikoni në vijim tregon MAR-in total të përkohshëm dhe trendin e pritur të tarifës mesatare gjatë periudhës së kontrollit.

MAR-et e përcaktuara janë përmbledhur në tabelën në vijim:

		----- Vlerësimi i përkohshëm -----				
		2013	2014	2015	2016	2017
KEK Minierat	€m	89.3	89.9	92.0	92.6	87.2
KEK Gjenerimi (pa lignit)	€m	63.3	63.7	63.6	63.5	66.1
Kostot tjera të blerjes së energjisë	€m	8.8	13.6	15.2	15.2	34.3
KOSTT TSO+MO (pa humbje)	€m	14.7	15.2	16.0	16.8	17.7
KEDS DSO (pa humbje)	€m	30.8	33.5	36.0	37.6	39.1
KEDS PES (pa blerje të energjisë)	€m	32.3	32.5	30.5	30.9	32.2
Gjithsej	€m	239.2	248.5	253.4	256.5	276.6

## 2 Hyrje

Në shkresën e datës 8 qershor 2012, ZRRE-ja shpalli fillimin e Shqyrtimit të shtatë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE7), i cili, për herë të parë, do të mundësojë përcaktimin e të hyrave maksimale të lejuara të të licencuarëve për periudhë shumë vjeçare. Këto të hyra maksimale të lejuara do të duhej, me ligj, të ishin të mjaftueshme për të mbuluar kostot e arsyeshme operative dhe kapitale të kryerjes së aktiviteteve të licencuara. Për të përckatuar nëse të hyrat janë adekuate, ZRRE duhet të vlerësojë me kujdes kostot e parapara të të licencuarëve dhe të bindet se propozimet e tyre janë të arsyeshme dhe të qëlluara. Të licencuarit janë të obliguar ligjërisht që ZRRE-së t'i ofrojnë të gjitha të dhënat të cilat ZRRE i konsideron të nevojshme për këtë analizë. Të licencuarve iu është kërkuar që t'i prezantojnë aplikacionet ZRRE-së dhe opinionit publik më 3 shtator. Që nga kjo datë, ZRRE ka punuar për së afërmi me kompaninë për të qartësuar aplikacionet fillestare. Të licencuarit që atëherë kanë parashtruar të dhëna dhe arsyetime domethënëse shtesë.

ZRRE dëshiron t'ju falënderohet të licencuarëve për pjesëmarrjen e tyre aktive në procesin e shqyrtimit deri tani. Kjo i ka mundësuar ZRRE-së dhe konsulentëve të saj që të fitojnë një pasqyrë të natyrës dhe përmasave të kostove të të licencuarve dhe parashikimet e tyre për periudhën SHTE7.

Në harmoni me Rregullat e publikuara të përcaktimit të çmimeve, ZRRE duhet të përcaktojë dhe të konsultohet lidhur me propozimet e veta për të Hyrat Maksimale të Lejuara që mund t'i mbulojnë të licencuarit gjatë periudhës rregullative si dhe arsyetimet për këto. Rregullat lejojnë që ZRRE të ndryshojë, fshijë apo të zëvendësojë çdo pjesë të propozimeve të të licencuarëve kur veprimet e tilla janë të arsyetuara.

Ky dokument është pjesë përbërëse e vlerësimit të përkohshëm. Dokumenti përmbledhë qëndrimin e përkohshëm të ZRRE-së për një numër elementesh kyçe të cilët e përbëjnë çmimin total të energjisë elektrike. Ai gjithashtu përshkruan qasjen dhe qëndrimin e ZRRE-së lidhur me një numër të çështjeve më të gjera që prekin të gjitha licencat. Së bashku me këtë dokument, ZRRE ka dhënë një dokument të detajshëm me të cilin vlerësohen të hyrat e nevojshme për çdo të licencuar individual.

## 3 Harmonizimi i vitit rregullativ me vitin kalendarik

Deri më sot, sektori i ka raportuar rregullatorit mbi bazë të vitit financiar prej prillit në mars. Për dallim prej kësaj, kompanitë i raportojnë llogaritë statutore mbi bazë të vitit kalendarik. ZRRE konsideron se nisma për të harmonizuar dy vitet e raportimit është e mirëseardhur në përmirësim të aftësisë së saj për të pajtuar llogaritë rregullative me ato statutore, duke dhënë një pasqyrë më të mirë të pozitave financiare të të licencuarve. ZRRE gjithashtu konsideron se do të ishte më e lehtë për të licencuarit që t'i mbajnë llogaritë e veta nëse vitet kalendarike janë të njëjta. ZRRE ka ngritur këtë pyetje në konsultimin e tij fillestar të tarifës shumë vjeçare (TSHV) në qershor këtij viti dhe nuk ka pranuar vërejtje nga të licencuarit. ZRRE prandaj propozon që kontrolli i vitit 2013 të hyjë në fuqi më 31 dhjetor, kontroll nëntë-mujorësh.

## 4 Kohëzgjatja e kontrolleve

Rregullat e ZRRE-së për përcaktimin e çmimeve e përcaktojnë kohëzgjatjen e kontrolleve të të hyrave për periudhat e rregulluara për çdo të licencuar si në vijim:

- 4 vjet për gjeneratorin e rregulluar;
- 5 vjet për transmisionin dhe shpërndarjen;
- 1 vit për furnizuesin publik të energjisë elektrike (FPEE-në).

Pritjet aktuale janë që, pas dekomisionimit të planifikuar të Kosova A në vitin 2017 dhe lëshimit në funksion të Termocentralit Kosova e Re (KRPP) do të jetë e domosdoshme që Kosova B të nxirret nga shërbimi për një periudhë më të gjatë për rehabilitime të zgjeruara, përfshirë kthimin e mundshëm në operacion të CHP-së. Pasi që nuk ka ndonjë siguri lidhur me datën e një rehabilitimi të tillë, shtrirjen apo koston dhe KEK-u nuk ka mundur të ofrojë të dhëna për këtë, ZRRE e konsideron të duhur që të përcaktojë këtë kontroll fillestar shumë vjeçar të tarifës për prodhim për një periudhë prej katër viteve prej 2013 – 2016. Kjo mundëson përcaktimin e një kontrolli të ri prej 2017 e tutje kur nevojat për investim në Kosova B si dhe gjendja e ardhshme me furnizim pas heqjes nga funksioni të Kosova A të bëhet më e qartë. Ky ndryshim gjithashtu ka përparësinë sepse lejon edhe ndarjen e periudhave të ardhshme të kontrollit të çmimeve në faza ashtu që nuk është e domosdoshme që të rishqyrtohet kontrolli i të gjithë të licencuarve për një herë. Për të lehtësuar barrën e ndërlidhur me përcaktimin e kontrollit shumë vjeçar të të hyrave në të ardhmen, Rregulli për përcaktimin e çmimeve ka paraparë një periudhë kalimtare para hyrjes në fuqi të këtyre kohëzgjatjeve në mënyrë që të ndajë në faza periudhat e shqyrtimeve të ardhshme.

Format raportuese të ZRRE-së i kanë obliguar të licencuarit që të ofrojnë të dhënat e parashikimit prej 2013 deri në fund të vitit 2017. Këto parashikime i kanë lejuar ZRRE-së që të kuptojë kahjen e mundshme të kostos së tërë zinxhirit të furnizimit gjatë tërë periudhës pesë vjeçare. Mirëpo, për përcaktimin e kontrollit të të hyrave MAR, ZRRE do të ndjekë dispozitat e Rregullit për përcaktimin e çmimeve. Prandaj, ZRRE propozon që kontrolli për divizionin e gjenerimit të KEK-ut fillon më 1 prill 2013 dhe zgjat deri më 31 dhjetor 2016. Kontrollat për biznesin e KEK-ut të Operatorit të Sistemit të Distribucionit (OSD) dhe bizneset e KOSTT-it për Operator të Sistemit dhe të Tregut hyjnë në fuqi më 1 prill 2013 por zgjasin deri më 31 dhjetor 2017. Si rezultat i barazimit të vitit rregullativ të përshkruar më herët, periudha rregullative e FPEE-së së KEK-ut do të zgjas prej 1 prillit deri më 31 dhjetor 2013.

## 5 Ndryshimet në periudhën e ardhshme të kontrollit

Tarifat shumë vjeçare do të mbulojnë një periudhë kohore gjatë së cilës sektori i energjisë elektrike do të pësojë ndryshime të mëdha, disa prej të cilave mund të kenë ndikim në koston e energjisë elektrike në vitet e ardhshme. Këta faktorë janë të përshkruar më poshtë, krahas qasjes indikative të ZRRE-së për secilin rast.

### 5.1 Investimet e ardhshme në Gjenerim

Strategjia e Qeverisë për energjinë propozon dy fusha të rëndësishme të pjesëmarrjes së sektorit privat në sektorin e prodhimit dhe atë: në ndërtimin e një termocentrali të ri me djegie tërëgjilje,

## Vlerësimi i përkohshëm - Pasqyrë

"Kosova e Re", si dhe rehabilitimi i Kosovës B1 dhe B2 për t'i vënë stacionet në përputhje të plotë me kërkesat mjedisore të BE-së. Strategjia parashikon edhe mbylljen e stacionit Kosovës A në fund të vitit 2017. Edhe pse fillimisht është pritur të jetë një transaksion i kombinuar, Qeveria njoftoi kohë më parë se tenderët për ndërtimin e Kosovës së Re dhe rehabilitimin e Kosova B do të jenë të ndarë. Deri tani, nuk është shpallur zyrtarisht ri-tenderimi për cilindo prej këtyre transaksioneve.

### 5.2 Tantiema për shfrytëzim të linjtit

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar një vendim për rritjen e tantiemës për shfrytëzim të linjtit duke filluar nga 1 janari 2013.

Në shqyrtimin e gjashtë të tarifës së energjisë elektrike (SHTE6), ZRRE ka përfshirë një lejesë për koston e rritur të furnizimit me linjit për këtë periudhë e cila duhet të shpërndahet gjatë 12 muajve të periudhës së kontrollit 2012-2013, duke e zbutur me këtë rritjen e çmimit. Çmimet e energjisë elektrike do ta ndajnë efektin e plotë të rritjes së taksës për linjit më 1 prill 2013.

### 5.3 Balanca e energjisë dhe importet

Kërkesat nga konsumatorët dhe disponueshmëria vendore e energjisë janë shtytës kyç të çmimeve të ardhshme të energjisë elektrike. Për qëllime të këtij rishqyrtimi, ZRRE ka punuar me të licencuarit për të azhurnuar bilancin e energjisë së Kosovës për pesë vitet nga 2013 dhe kjo është dhënë në një tabelën në vazhdim.

*Tabela a*

Balanca e energjisë 2013 (e thjeshtëzuar)	Realiz. ----- Nov 11 -Oct 12	Vlerësimi i përkohshëm -----				
		2013	2014	2015	2016	2017
Shitjet në shpërndarje	GWh 2,998.9	3,201.6	3,383.2	3,535.2	3,667.2	3,776.1
Humbjet në distribucion	GWh 1,538.5	1,208.3	1,091.9	991.3	882.7	767.9
		<b>33.9%</b>	<b>27.4%</b>	<b>24.4%</b>	<b>21.9%</b>	<b>19.4%</b>
Furnizimet e pafaturuara	GWh 210.0	212.0	220.0	230.0	240.0	250.0
Shitjet në transmision	GWh 516.9	621.9	621.9	621.9	621.9	621.9
LOMAG dhe konsumi i KEK-ut	GWh 293.0	295.0	330.0	330.0	330.0	330.0
Humbjet në transmision	GWh 107.6	109.9	111.1	112.0	112.0	106.2
		<b>1.8%</b>	<b>1.8%</b>	<b>1.8%</b>	<b>1.8%</b>	<b>1.8%</b>
Eksportet	GWh 284.3	492.0	451.0	440.0	403.0	84.0
<b>GJITHSEJ KËRKESA</b>	<b>GWh 5,949.4</b>	<b>6,140.8</b>	<b>6,209.2</b>	<b>6,260.4</b>	<b>6,256.8</b>	<b>5,936.1</b>
Prodhimi i kyçur në shpërndarje	GWh 27.9	35.0	36.0	38.0	36.0	38.0
Prodhimi i kyçur në transmision	GWh 5,266.0	5,672.0	5,688.0	5,720.0	5,732.0	5,265.0
Importet	GWh 655.4	433.8	485.2	502.4	488.8	633.1
<b>GJITHSEJ FURNIZIMI</b>	<b>GWh 5,949.4</b>	<b>6,140.8</b>	<b>6,209.2</b>	<b>6,260.4</b>	<b>6,256.8</b>	<b>5,936.1</b>

### 5.4 Privatizimi i Shpërndarjes dhe i Furnizimit të KEK-ut

Në tetor 2012 Qeveria nënshkroi marrëveshjen e shitblerjes me konzorciumin e investitorëve për bizneset e rregulluara të shpërndarjes dhe të furnizimit publik të energjisë elektrike të KEK-ut. Bizneset do të barten në pronësi dhe kontroll të konzorciumit më 6 maj 2013, pasi të jenë përmbushur disa kushte.

Në aplikacionet e tyre, KEK-u ka bërë me dije se pikësynimi i parë i planit të tij të investimit është që të shenjëstrojë investimet kapitale në ato lokacione ku ka performancë më të dobët të rrjetit të shpërndarjes. ZRRE nuk pret që pronari i ri i biznesit të devijojë në mënyrë të ndjeshme nga qasja e tanishme e KEK-ut. Mirëpo, nëse investitori dëshiron të rishqyrtojë projektet në atëherë ai duhet të aplikojë në ZRRE për të bindur ZRRE-në se ndryshimet në projekte sjellin përfitime të barazvlefshme ose më të mëdha për konsumatorët e energjisë elektrike. Në raste të tilla, ndryshimet eventuale në MAR dhe RAB të të licencuarit pasojnë në Shqyrtimin e ardhshëm Periodik.

### 5.5 Reflektimi i kostos

Legjislacioni i BE-së dhe i Kosovës kërkojnë eliminimin e ndër-subvencioneve përbrenda çmimeve të energjisë elektrike. ZRRE është në procesin e evidentimit të ndër-subvencioneve dhe gjetjen e mekanizmave për eliminimin e tyre.

Duke marrë parasysh shtytësit e tjerë kryesor të kostos, dhe në veçanti përfshirjen e rritjes së plotë të taksës për shfrytëzim të linjitet në tarifa, ZRRE konsideron se ri-balancimi i tarifave duhet të bëhet gradualisht gjatë periudhës së plotë të Periudhës Rregullative.

Edhe pse ribalancimi i tarifave për të larguar ndër-subvencionimin do të duhej të kishte një ndikim pozitiv në koston e bërjes së biznesit në Kosovë, forcimi i ekonomisë së vendit, prodhuesit e cenueshëm vendor mund të kenë nevojë për mbrojtje nga ndikimi i rritjes së çmimeve. Pasi që çështjet e mbrojtjes sociale janë në kompetencë të qeverisë qendrore, ZRRE bën thirrje për mbështetje shtesë të targetuar financiare për të mbrojtur konsumatorët në nevojë të cilët janë më së paku në gjendje t'i përballojnë këto rritje të çmimeve.

## 6 Zhvillimi i MAR-ëve

ZRRE ka për obligim të përcaktojë të hyrat maksimale të lejuara për çdo divizion të rregulluar për KEK-un dhe KOSTT-in. Rregulli për përcaktimin e çmimeve për çdo biznes të licencuar përcakton saktësisht se cilat kosto janë të lejuara për çdo veprimtari të rregulluar. Duke qenë se çdo kompani ka më shumë se një licencë, procesi gjithashtu i kërkon ZRRE-së të shqyrtojë alokimin e kostove qendrore, siç janë ato të administratës qendrore, të çdo biznesi i licencuar. Kostoja e përgjithshme e furnizimit të energjisë elektrike do të jetë shuma e të gjitha MAR-ëve, ndërsa tarifa e përgjithshme përcaktohet për të mbuluar atë shumë nga kategoritë e ndryshme tarifore.

Pjesa në vijim jep llogaritjen e përkohshme të ZRRE-së të kostove të lejuara për çdo veprimtari të licencuar. Në këtë fazë, disa kosto të jashtme, siç janë taksa e licencës së rregullatorit dhe mekanizmi i kompensimit ndërmjet OST-ve janë përjashtuar. Këto elemente do të përfshihen në Vendimin përfundimtar të ZRRE-së për SHTE7.



## **7 MAR – Ndryshimet dhe komponentët**

### **7.1 Ndryshimet në SHTE6**

Kontrolli kalimtar një-vjeçar (SHTE6) hyri në fuqi më 1 prill 2012 për të gjithë të licencuarit. Si pjesë e shqyrtimit aktual, ZRRE u ka kërkuar të licencuarve që të parashohin rezultatin e tyre sipas kontrollit aktual. Këto parashikime duhet të azhurnohen para se ZRRE të japë vendimin e tij përfundimtar lidhur me MAR-in shumë-vjeçar në shkurt 2013. Kur të licencuarit t'i kenë finalizuar llogaritë e veta lidhur me vitin aktual rregullativ, dallimet ndërmjet gjendjes së raportuar ZRRE-së për qëllime të përcaktimit të MAR dhe gjendjes sipas auditimit do të rregullohen përmes faktorit të korrigjimit në kontrollin e të hyrave.

### **7.2 Alokimi i kostove së administratës qendrore në Divizionet e licencuara**

Në parashitjet e veta të kostove të parashikuara, kompanitë kanë prezantuar kostot e tyre operative në disa kategori: shpenzimet e pagave, energjisë elektrike dhe komunalitë e tjera, mirëmbajtjes, materialeve dhe të furnizimeve, dispozitave për çështje ambientale, shpenzimeve të tjera operative dhe shpenzimeve interne. KEK-u dhe KOSTT-i kanë plotësuar formatet e raportimit në mënyra paksa të ndryshme. Mirëpo, nga aspekti rregullativ, të gjitha këto kosto duhet t'iu alokohen aktiviteteve të licencuara në mënyrë që ato të mund të mbulohen përmes MAR. ZRRE ka ndryshuar kostot e parashtruara të të licencuarve për administratën qendrore. Për të bërë këtë ndryshim, ZRRE ka shfrytëzuar ndarjen e KEK-ut për vitin 2012, dhe i ka aplikuar këto për çdo vit të SHTE7.

### **7.3 Përshtatjet e ZRRE-së në Capex e Opex**

Në harmoni me legjislacionin primar dhe me Rregullin për përcaktimin e çmimit, të licencuarit mund t'i mbulojnë shpenzimet e tyre operative dhe kapitale, kur këto janë arsyetuar si duhet, dhe ku nivelet e kostos janë konstatuar si të arsyeshme. Të licencuarit gjithashtu mund të fitojnë amortizimin për të gjitha asetet kapitale në bazën rregullative të aseteve dhe mund të kenë kthim të lejuar në ato asete të cilat nuk financohen nga grantet.

ZRRE me ndihmën e dy firmave të inxhinierëve konsultues ka shqyrtuar me vëmendje kostot e të licencuarve. Që nga shtatori, ZRRE ka pasur takime të shumëta me të dy kompanitë.

ZRRE, për qëllime të këtyre vlerësimeve të përkohshme, ka pranuar në masë të madhe propozimet e të licencuarve për investime për periudhën e kontrollit. Për KOSTT-in, ZRRE konsideron se projektet e propozuara kapitale janë arsyetuar në mënyrë të kënaqshme dhe janë rezultat i një procesi të matur dhe të qëlluar të planifikimit. Në rast të KEK-ut, ZRRE konsideron se rreth €102 të milion të projekteve kapitale në mihje janë propozuar pa arsyetim të mjaftueshëm. Në këtë fazë, ZRRE ka përfshirë një dispozitë për këto projekte në Vlerësimin e përkohshëm të MAR. Mirëpo, nëse KEK-u nuk siguron arsyetim adekuat për këto projekte, ZRRE mund t'i eliminojë nga Vlerësimi i tij përfundimtar. Për OSSH-në, ZRRE konsideron se një ulje modeste në shpenzimet kapitale mund të jetë e qëlluar, e cila do të pasqyrojë kostot relativisht të larta të raportuara nga kompania për disa lloje të pajisjeve.

## Vlerësimi i përkohshëm - Pasqyrë

Tabela b

Ndryshimet e ZRRE-së në Capex sipas të licencuarve	Parashikimet e kompanisë €m	Vlerësim i ZRRE-së €m	Ulja %
KEK Mihja	160	145	-9%
KEK Gjenerimi A	65	56	-14%
KEK Gjenerimi B	40	40	0%
KOSTT	120	120	0%
OSSH	114	100	-12%
FPEE	2	2	0%

Në aspektin e shpenzimeve operative, ZRRE-ja ka shqyrtuar dhe përshtatur nivelet e kostos operative të propozuara nga të licencuarit. Për çdo të licencuar, ZRRE-ja ka hequr rritjet në nivelet e pagave mbi normën e përgjithshme të inflacionit që ishin propozuar nga kompanitë. Rregullimet përkatëse në nivelet e përgjithshme të shpenzimeve operative janë të detajuara në vlerësimet e hollësishme të përkohshme për çdo të licencuar dhe janë përmbledhur më poshtë.

Tabala c

Ndryshimet e ZRRE-së në sipas të licencuarve	Parashik. i kompanisë €m	Vlerësimi i ZRRE-së €m	Ulja %
KEK Minierat	191.5	167.7	-13%
KEK Gjenerimi A	84.5	75.6	-11%
KEK Gjenerimi B	71.2	65.0	-9%
KOSTT	61.5	38.7	-37%
OSSH	86.9	76.6	-12%
FPEE	71.4	61.6	-14%

## 7.4 Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit (WACC)

ZRRE ka supozuar Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC) duke u bazuar në Vendimet ekzistuese të Bordit dhe në vlerësimet paraprake të kërkeses për Kthim të ekuitetit, kostove aktuale të financimit të borxhit dhe nivelit aktual të leverazhit (duke përfshirë kufizimet e paraqitura në lidhje me leverazhin në diskutimet e mëhershme të ZRRE-së lidhur me WACC)

Fillimisht ZRRE ka supozuar se të gjitha kompanitë e rregulluara kërkojnë kthim komercial në ekuitet. Më tutje ZRRE ka kërkuar nga Qeveria udhëzime lidhur me nivelin e kthimit në ekuitet që Qeveria do të kërkonte si pronare e vetme e kompanive publike. Qeveria është shprehur se do të konsiderojnë kthim më të ulët në ekuitet nga operatorët në pronësi publike krahasuar me kthimin që do të mund të kërkohej nga një operator privat. Vlerësimi fillestar i ZRRE-së është se niveli i kthimit në ekuitet prej 8.0% (pas taksës) do të ishte i duhur për kompani në pronësi publike. ZRRE ka përdorur këtë kthim në ekuitet për të vlerësuar WACC-un e kompanive publike.

## Vlerësimi i përkohshëm - Pasqyrë

WACC-et rezultuese janë përmbledhur në tabelën në vijim

Tabala e

Vlerësimet e ZRRE-së për WACC për të licencuarit (reale)	KEK Mihja	KEK Prodhimi	KOSTT
Kostoja e ekuitetit pas tatimeve	8.0%	8.0%	8.0%
Kostoja e ekuitetit para tatimeve	8.9%	8.9%	8.9%
Kostoja e borxhit	4.0%	3.9%	3.5%
Gearing*	0.7	0.4	0.4
<b>WACC</b>	<b>5.50%</b>	<b>6.89%</b>	<b>6.73%</b>

\* llogaritur si borxh / (borxh + ekuitet)

### 7.5 Faktorët e efikasitetit

Faktorët e efikasitetit aplikohen gjerësisht në energjinë e rregulluar dhe në sektorët e tjerë të kompanive publike në botë për të nxitur menaxhime efikase dhe për të ofruar vlerë të rritur për konsumatorët. Rregullat e ZRRE-së për përcaktim të çmimeve e obligojnë ZRRE-në që të përcaktojë Faktorët e efikasitetit të cilët do të vlejné për kostot operative dhe të mirëmbajtjes. Rregullat e përcaktimit të çmimeve ofrojnë udhëzime se si ZRRE përcakton faktorët. Në veçanti, ZRRE duhet të merr parasysh kostot historike dhe të parashikuara si dhe cilësinë e shërbimeve. Duhet të krahasojë koston e energjisë elektrike dhe efikasitetin si në Kosovë ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar.

Duke përcaktuar një faktor tjetër të ndryshëm prej zeros, MAR-et e të licencuarve përshtaten automatikisht në çdo vit të kontrollit, si për inflacion ashtu edhe për përqindjen e faktorit. Faktori pozitiv i efikasitetit do të ulte të hyrat në terma reale, faktori negativ do të lejonte rritjen e tyre në terma reale. Këta faktorë definojnë në çdo shqyrtim periodik, dhe zgjasin gjatë tërë periudhës së shqyrtimit të tarifës shumë-vjeçare. ZRRE propozon përcaktimin e një faktori të vetëm të efikasitetit për çdo të licencuar i cili do të përfaqësonte përfitimet e pritura nga një operator efikas. Duhet të ceket se për Shpërndarjen dhe Furnizimin, Faktori i efikasitetit është para-caktuar me Vendimin e Bordit të ZRRE-së në shkurt të vitit 2012.

Përcaktimi i faktorëve të tillë të efikasitetit nuk është rezultat i llogaritjes, por i një gjykimi të informuar bazuar në informatat në dispozicion. Për të caktuar faktorin e efikasitetit, ZRRE ka shqyrtuar praktikën më të mira ndërkombëtare dhe ka marrë parasysh studimet e produktivitetit në BE.

Përvojat ndërkombëtare sugjerojnë se kompanitë e shërbimeve publike mund të bëjnë fitime më të mëdha të prodhimit në vitet e hershme të vënies në zbatim të faktorit të efikasitetit. Studimi i ZRRE-së i praktikave ndërkombëtare ka dhënë vlera tipike në rangun prej 0% deri +4%.

Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së tregon sektori i energjisë elektrike në Kosovë nuk duket të jetë shumë jo-efikas në krahasim me operatorët e tjerë të cilët kryejnë funksione të ngjashme gjetiu në rajon. Megjithatë ZRRE konsideron kursime të mëtutjeshme mund të arrihen. Në propozimin e faktorëve në vijim, ZRRE iu lë kompanive të identifikojnë se ku mund të bëhen kursime, dhe vë në

## Vlerësimi i përkohshëm - Pasqyrë

pah se arritja e fitimeve në efikasitet përtej niveleve të sugjeruara nga faktorët e efikasitetit do të rezultojë në rritje të MAR-it për të licencuarit.

Faktorët e propozuar të efikasitetit	2013	2014	2015	2016	2017
Miniera	4.00%	4.00%	4.00%	4.00%	n/a
Gjenerim	4.00%	4.00%	4.00%	4.00%	n/a
KOSTT	4.00%	4.00%	4.00%	4.00%	4.00%
OSSH	0.00%	0.00%	0.00%	5.00%	5.00%

## 8 Vlerësim i përkohshëm i MAR-it

Kjo pjesë përmbledhë MAR-et e përkohshëm për çdo të licencuar, duke marrë parasysh rregullimet dhe komponentët e përshkruara në pjesën 6 më lartë.

### 8.1 MAR-et e përkohshme

Tabela në vijim paraqet vlerësimin e përkohshëm të MAR-it nga ZRRE-ja për çdo veprimtari të licencuar. Edhe pse ZRRE nuk e cakton MAR-in për divizionin e Mihjes, i njëjti vlerësim duhet të bëhet edhe për mihjen në mënyrë që të përcaktohet Kostoja e supozuar e furnizimit me linjit. Rezultatet janë dhënë këtu në një format të krahasueshëm për lehtësi interpretimi.

*Tabela g*

		Vlerësimi i përkohshëm				
		2013	2014	2015	2016	2017
KEK Minierat	€m	89.3	89.9	92.0	92.6	87.2
KEK Gjenerimi (pa lignit)	€m	63.3	63.7	63.6	63.5	66.1
Kostot tjera të blerjes së energjisë	€m	8.8	13.6	15.2	15.2	34.3
KOSTT TSO+MO (pa humbje)	€m	14.7	15.2	16.0	16.8	17.7
KEDS DSO (pa humbje)	€m	30.8	33.5	36.0	37.6	39.1
KEDS PES (pa blerje të energjisë)	€m	32.3	32.5	30.5	30.9	32.2
Gjithsej	€m	239.2	248.5	253.4	256.5	276.6